



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, NGA RADHËT E GJYQATARËVE, PËR NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1 të nenit 136, në pikën 1 të nenit 147 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3 të nenit 8, në shkronjën “a” të pikës 1 dhe në pikën 5 të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 61, në shkronjën “ç” të nenit 86 dhe në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, **me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, ka vendosur :**

Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile.

Shpalljen e kërkesës për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar, në një pozicion në sistemin gjyqësor ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të emërimit në Gjykatën e Lartë, të parashikuara në pikën 3 të nenit 8, në pikën 5 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të marrë pjesë në këtë procedurë të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të pasqyruar edhe më poshtë.

Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen në pikën 3 të nenit 8, në pikën 5 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si mëposhtë:

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
- b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Plotësimi i kritereve të kandidimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionet e lira të shpallura;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Bulevardi “Zog I”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Kujdes: Çdo kandidat të ketë në vëmendje dhe përcaktimin e pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës”.

Ky njoftim është publikuar më datë 28.02.2020.